



L A J M E

RRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE NË FUSHËN E SIGURISË KIBERNETIKE

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në drejtimin e Koordinatorit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike z.Igli Tafa, si dhe mbështetjen e e-GA, po zhvillojnë trajnimin e dedikuar për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafeve përgjegjëse për auditet e sigurisë kibernetike.

Trajnimi ISO/IEC 27001:2022 zhvillohet në datat 13-16 Mars 2023, ku përfaqësues janë institucionet kryesore të sigurisë në vend, si AKCESK, AKSHI, Policia e Shtetit, SHISH.

Qëllimi i këtij trajnimi është përgatitja e Lead Auditors, me azhurnimet më të fundit të këtij standardi, si dhe njohja me kërkesat për implementim dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit brenda organizatës/institucionit apo Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit.



14 Mars 2023

KONTAKT

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I, Tiranë/Shqipëri 04-22-21039

email: info@cesk.gov.al Web: www.cesk.gov.al